

2009
dt 11.04.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Nr. 455 / Prot.

Elbasan më 9 . 4 . 2025

Lënda: Konfirmim Akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ndryshuar me ligjin nr.36/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut"", datë 18.04.2024, pasi verifikuam ligjshmërinë e aktit tuaj nr.32 datë 26.03.2025 "Për një ndryshim në VKB nr.116 datë 27.12.2024", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI
ILIR BEJTJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.28.03.2025

Nr. 1761 prot

Nr.32 dt.26.03.2025

**“PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 116, DATË 27.12.2024, TË KËSHILLIT
BASHKIAK, “PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË STREHIMIT”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, nenit 113, të ligjit 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative” i ndryshuar, nenit 2, pika 51 dhe nenit 15, pika 5, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimit nr. 116, datë 27.12.2024, të Këshillit Bashkiak, “Për ngritjen e komisionit të strehimit, Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me datë 26.03.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

V E N D O S I :

Në vendimin nr. 116, datë 27.12.2024, të Këshillit Bashkiak, “Për ngritjen e komisionit të strehimit”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3, shkronja “a” ndryshohen si më poshtë:
“a. Bajram Pishkashi- Sekretar i përgjithshëm.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, të miratojë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këtij komisioni.
3. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Komisioni i Strehimit për zbatimin e këtij vendimi
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BIÇAKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____, datë __.03.2025

“PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 116, DATË 27.12.2024, TË KËSHILLIT
BASHKIAK, “PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË STREHIMIT”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, nenit 113, të ligjit 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative” i ndryshuar, nenit 2, pika 51 dhe nenit 15, pika 5, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimit nr. 116, datë 27.12.2024, të Këshillit Bashkiak, “Për ngritjen e komisionit të strehimit, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 116, datë 27.12.2024, të Këshillit Bashkiak, “Për ngritjen e komisionit të strehimit”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3, shkronja “a” ndryshohen si më poshtë:
“a. Bajram Pishkashi- Sekretar i përgjithshëm.
2. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, të miratojë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këtij komisioni.
3. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Komisioni i Strehimit për zbatimin e këtij vendimi
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI BASHKISË

Mariglen Disha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 161 Prot.

Elbasan më 15.1. 2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.116 datë 27.12.2024 “Për ngritjen e komisionit të strehimit”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ali Mysliu

16

06.01.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.31.12.2024

Nr.6514 prot

Nr.116 dt.27.12.2024

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË STREHIMIT

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54 shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", nenit 2, pika 51 dhe nenit 15, pika 5, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", Këshilli Bashkiak I mbledhur sot me date 27.12.2024 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI:

1. Pranë Bashkisë Librazhd të ngrihet dhe funksionojë Komisioni i Strehimit.
2. Komisioni i Strehimit shqyrton dhe merr vendime në lidhje me kërkesat e paraqitura nga çdo subjekt që kërkon për të përfitur nga njëri prej programeve sociale të strehimit, si dhe për çdo çështje tjetër që parashikohet nga legjislacioni për strehimin, çështjet sociale apo nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë shqyrtimin e kërkesave nga ky komision.
3. Komisioni i Strehimit përbëhet nga 5 anëtarë, si më poshtë:
 - a. Ermir Sulollari – Zv Kryetar **Kryetar**
 - b. Klodian Burgjia – Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit të Territorit dhe Pronës **Anëtar**
 - c. Rexhep Shaka Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Sociale **Anëtar**
 - d. Adela Haskurti Përgjegjëse Sektorit të Projekteve, Investimeve dhe Strehimit **Anëtar**
 - e. Klorida Lleshi Juriste **Anëtar**
4. Komisioni i Strehimit asistohet nga një sekretariat administrativ, i cili asiston komisionin gjatë gjithë veprimtarisë së tij. Roli i sekretarit administrativ i caktohet z. Ani Teta me detyrë specialist Strehimi.

Sekretari administrativ është përgjegjës për:

 - a. Marrjen në dorëzim të aplikimeve dhe kërkesave që janë objekt i shqyrtimit dhe vendimmarrjes së Komisionit;
 - b. Shpërndan dhe vë në dispozicion të anëtarëve, materialet për mbledhjen e radhës, brenda 5 ditëve pune para datës së mbledhjes;